

VIZIONE BASHKËKOHORE NË OPUSIN
LETRAR TË VEPRAVE
TË MEHMET AKIF ERSOJIT^{246]}

Hyrje

Historia e njerëzimit njih figura madhore që me pikëpamjet dhe vizionin e tyre kanë lënë gjurmë të thella në rrjedhat dhe zhvillimin shoqëror të një bashkësie, por edhe kolosë që kanë kapërcyer kufijtë e vijës gjeografiko-gjakore dhe janë shndërruar në trashëgimi të njerëzimit, në kolosë të racës njerëzore. I tillë është edhe Pejani ynë (Mehmed Akifi 1873-1936), poet dhe mendimtar, ky monumental që ka frymëzuar kauzën e një kombi dhe të një bashkësie besimore (*ummeti*), një vigan i shpirtit, personalitetit, karakterit dhe moralit të veçantë, një idealist i madh, një nga “plejada e shkrimtarëve shqiptarë që i dhanë vepra madhore kulturës osmane”.^{247]} Mehmed Akifi, si një “fëmijë i kataklizmave”, njeri që ka përjetuar me trishtim zhbërjen e një megaperandorie, një periudhë të tërë në Turqi dhe në trojet e tjera osmane, për shkak të kriterit vlerësues ideologjik, u trajtua shtrembër, mbetet i shënuar në historinë turke dhe shqiptare si njeriu që diti që kohës t’ia thotë fjalën e vet. Nevoja për kursin e tij del në shesh në veçanti në kohën tonë, kur përjetohet një krizë e rëndë gjithëkombëtare dhe gjithislame. Por kjo kataklizmë atë e ka bërë më të pjekur, e ka nxitur të kërkojë shkaqet dhe rrugëdaljet. Ai ka përjetuar zhgënjimin dhe brengën e thellë të rrënimit të idealeve. Mund të thuhet se mjedisi dhe edukata e arsimit që ka marrë, kanë ndikim të madh në zhvillimin e tij si poet, si njeri dhe si *shoqëri-ndërtues* përmes ligjëratës poetike.

²⁴⁶ Kumtesë e prezantuar në konferencën shkencore ndërkombëtare “Mehmed Akif Ersoj: Poeti i qytetërimit tonë”, 12 mars 2011, Prishtinë.

²⁴⁷ Mehmed Akif, *Fletët (Safahat)*, Logos-A, Shkup, 2009, parathënia.

Ai i ka bërë të amshueshme periudhat e përjetuara të shoqërisë osmane në kryeveprën e tij *Safahat*.^{248]}

2. Safahat: një analizë dhe epos sociologjik

Ekziston një mendim konsensual se *magnum opusin* e Mehmed Akifit e përbën vepra poetike “Fletët” (ose “Periudhat”). Ky libër vëllimor i Akifit është një epos i vërtetë sociologjik, një sociologji alternative, shprehur përmes fjalëve poetike, por me analiza të thukëta sociologjike, me trajtime të vërteta të inxhinerisë sociale. “Të bësh sociologji do të thotë të kesh frymë dinamike, të merresh me ndryshimet sociale, me zhvillimet e shoqërisë, të përpiqesh të kuptosh, të interpretosh dhe të përshkruash objektivisht rrafshin social”. Pikërisht me këtë merret Akifi. Ajo që bën Pejani, është një analizë biografike, trajton lidhjen mes manifestimeve shoqërore, ngjarjeve politike, kushteve jetësore etj. Ai, duke njohur mirë etnopsikologjinë e shoqërisë osmane, kalon në faktet sociale, në atë që ka parë e vëzhguar me sy si të sociologut, me metodën e mbiquajtur “sy e veshë”:

... *hayal ile yoktur benim alışverişim*
İnan ki her ne demişsem görüp de söylemişim.
(Jo, s'kam me fantazira dhënë e marrë...
Besoni, çfarëdo që të kem thënë, e kam parë).^{249]}

Kjo vepër, në fakt, shpreh frymën e tij për t'u përballur me “sëmundjet sociale”, tregon ndjeshmërinë dhe opozitarizmin e tij shoqëror, gjë që vërehet më së miri në kundërshtimin ndaj regjimit të Abdylhamidit II, duke kërkuar një sistem të bazuar në traditën islame dhe në solidaritet e liri.^{250]} Ersoji është një poet shoqëror, subjektet që i trajton, i huazon nga realiteti shoqëror, artin nuk e bën për art, por për atdheun dhe popullin e vet. Ai sikur e ka pasur pasion të rrëfejë përmes poezisë gjithë atë që ka përjetuar. Akifi është një poet që gëzohet dhe qan bashkë me

²⁴⁸ “Prof. Dr. Suleyman Hayri Bolay ile Mehmet Akif’in Dusunceleri Hakkında”, <http://yayim.meb.gov.tr/dergiler/sayi73/soylesi.pdf>

²⁴⁹ *Fletët*, 320.

²⁵⁰ M. Orhan Okay & M. Ertugrul Duzdag, “Mehmet Akif Ersoy”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, vëll. XVIII, Ankara 2003, f. 436.

gëzimin dhe lotët e popullit. *Safahat*-i përbën një rrëfim të gjendjes së shoqërisë osmane-turke-islame mes viteve 1908-1923, me të gjitha dimensionet e saj. Ai, përveç si autor i himnit kombëtar dhe si prijës shpirtëror i Luftës Kombëtare turke për çlirim, njihet edhe si intelektual musliman, si poet islamist, si përfaqësues më i fortë dhe më në zë i lëvizjes islamiste²⁵¹ të kohës kur në garë ishin tri format e politikës (Jusuf Akçura: islamizmi, turqizmi dhe osmanizmi). Atëbotë, dërmimi ekonomik, politik dhe shoqëror që bashkësitë islame përjetuan për shkak mbetjes prapa në aspektin teknologjik, ishin temat kryesore të intelektualëve të kohës. Përderisa një pjesë e “elitës” ishin për imitim të plotë të qytetërimit dhe kulturës perëndimore, islamistët ishin për përcjellje të teknologjisë, por duke ruajtur besnikërinë dhe lidhjen e mirëfilltë me burimet islame, me traditën, duke pohuar se shkaqet e prapambetjes ishin largimi prej islamit autentik dhe keqkuptimi i tij.²⁵² Sipas tij, fjala qoftë edhe si druri, duhet të shpjegojë kauzën, thelbin për të cilin një popull përpigjet dhe synon. *Periudhat* është refleksion i simbolit të besimit dhe vullnetit kryengritës.²⁵³

Shprehur me terminologjinë sociologjike të Eëberit, Akifi ka idenë e afinitetit përzgjedhës, tregon ndërvarësinë e një statusi ekonomik, një tjetri politik dhe një praktike fetare, të cilat formojnë një kompleks kulturor (qytetërimi) që i çon përpara sferat e ndryshme socio-kulturore.²⁵⁴ Ai insistonte në një “aksion kolektiv”, çdokënd që e shihte të aftë dhe me kapacitet, e nxiste të punonte në rrugën e shërbimit ndaj popullit dhe kombit.²⁵⁵ Ishte për veprimtari permanente, për dinamizëm social:

Fundja, për ty s'ka për asnjë çast të ndenjtur e pushim;

²⁵¹ Ekmeleddin Ihsanoglu, *Historija osmanske države i civilizacije – II*, IRCICA & Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo, 2008, f. 383.

²⁵² Ezel Erverdi dhe të tjerë (ed.), *Turk Dili ve Edebiyatı Ansiklopedisi*, Dergah Yayınları, vëll. III, f. 75.

²⁵³ Erverdi, f. 76.

²⁵⁴ Ali Pajaziti, *Fjalor i sociologjisë*, Logos-A & UEJL, f. 20

²⁵⁵ *Fletët*, parathënia.

I detyruar je të ecësh, pa u pajtuar me ç'ke arritur e ç'do të arrish!^{256]}

I çmonte aktorët shoqërorë prodhues (*generative actors*), të cilët janë shtytës të ndryshimeve shoqërore, promovojnë ndryshime kulturore duke i (ri)përkufizuar normat kulturore.

Ai shfaqte respekt të madh për elitën dhe intelektualët, i cilëson si figura të përsosura, shpresë e kombit, kandila të edukatës. Ersoji qan për Ibrahim beun, një prej *njerëzve të rrallë të ditur e të virtytshëm të përgatitur nga dheu i pastër i Lindjes dhe shton se ky njeri i madh, që i njihte gjuhët e Lindjes në mënyrë letrare, që i pati mësuar saktë frëngjishten dhe rusishten, sikur të mos ishte nga natyra mik i thjeshtësisë dhe armik i famës, nuk do të vdiste në spitalet e të varfërve.*^{257]}

*Me përëndimin tënd, sot bota është groposur n'errësirë;
Ato mëngjese nazemadhe nuk lindin më sot!*^{258]}

...

*Pse përëndove shpejt ti, o yll i Lindjes,
Përsosmërinë pa e kuptuar ende vatani i shkretë?*^{259]}

Mirëpo, ndërkohë është për një lidhje organike mes elitës dhe masës ose turmave popullore. Thotë se grigja me *masat që merr, shembin çdo dhunë e tirani.*^{260]}

Është kundër çkulturimit, kundër zëvendësimit të bindjeve dhe sjelljeve tradicionale me bindjet dhe mënyrat e sjelljes së kulturës dominuese, si dhe injektimit të vlerave, mendimeve, bindjeve dhe të formave të tjera shoqërore e kulturore.

Ai ishte kundër anomisë, koncept ky dyrkeimian që ka të bëjë me situata shoqërore në të cilat shfaqen çrregullime të ndërjegjes publike, mungesa, pezullimi ose mosefikasiteti i normave, ligjeve, rregullave dhe vlerave shoqërore, që shpien drejt çorganizimit dhe destabilizimit të shoqërisë. Ai kundërshton *çorganizimin shoqëror (social disorganization)* si gjendje strukturore shoqërore e shthurjes dhe çrregullimit, e shkaktuar nga ndryshimet e shpejta

²⁵⁶ *Fletët*, f. 172.

²⁵⁷ *Fletët*, f. 156.

²⁵⁸ *Fletët*, f. 158.

²⁵⁹ *Fletët*, f. 159.

²⁶⁰ *Fletët*, f. 171.

në institucionet, normat dhe vlerat e një trangu shoqëror, nga dërrmimi i shtyllave që e mbajnë një shoqëri të qëndrueshme. Ai është kundër dembelizmit, të cilin e ndërlihdh me vlera të larta të humbura, mirëqenie dhe lumturi të shkatërruar. Këtë gjendje patologjike e përshkruan në vargjet në vijim:

Kafeneja e mëhallës është element vrasës i Lindjes,

Është krejt si ato baltovinat e vjetra.

Populli i ndjerë i mjerë groposet pa vdekur,

I shuhet në këtë gropë vetëdija, pastaj vdes dhe vetë...²⁶¹

Ai është për shpëtimin e brezit të ardhshëm nga kjo gjendje e komës sociale që po përjetonte atëherë shoqëria osmane dhe thotë: “Në u djegsh vetë, madje, tët bir mos e përvëlo!”, është kundër defetizmit social, kundër shpresëthyrjes, është i vendosur në ndryshimet pozitive që mund të ndodhin në të ardhmen. Ai i drejtohet njeriut të kohës me këtë porosi:

Jo! Më parë këput zinxhirët që të kanë lidhur vendosmërinë!

Mos thuaj: “Mbaroi kjo punë!”, qëndresa nuk ka fund.

Mos u praps; o popull i ndjerë, shpresën mos e humb!²⁶²

Pata besim, s’u lëkund në vendosmëri, - thotë ai.

Sepse, për daljen në shesh të së vërtetës,

Suksesi e do kërkimin, vendosmërinë

Dhe kërkimi e vendosmëria, suksesin.

Dhe vendosmëria, s’bën dot pa qëllimin!

Poeti i shkruan elozhe patriotizmit, ndjenjës së atdhedashurisë, lavdëron brezin e të parëve:

Në vend të gjakut rridhte burrëri e trimëri,

Në zemra, në vend të jetës, dëshirë për të vdekur.

Mehmed Akifi familjen, si strukturë më e vogël që përgjatë historisë ka ruajtur vlerën e vet, e sheh si bërthamë të çdo shoqërie, e sheh si vend të realizimit të shëndetit social, të kënaqësisë individuale dhe kolektive: *Në botë, jeta familjare, jeta më me kënaqësi²⁶³*. Nga familja duhet të fillojë edukimi, gatimi i personalitetit: *Edukimi duhet të nisë nga familja, o bir!* Ai i qan

²⁶¹ *Fletët*, f. 211.

²⁶² *Fletët*, f. 305.

²⁶³ *Fletët*, f. 212.

rrënimit të familjes, bastardimit të vlerave familjare:

*“Ndryshe, mos e thëntë Zoti, familja në u rrëzoftë,
As krahët më të fortë s’e ngrenë, s’ka më mundësi!”²⁶⁴*

Akifi me një gjuhë të ashpër i ka kritikuar ata që tentojnë të bëjnë revolucion në strukturën familjare. Sipas tij, ata do të dëshpërohen, u del duarsh nderi.

Është armik i përbetuar i injorancës. Kishte opinionin se shoqëria nuk mund të jetonte pa dituri dhe kulturë. U jepte rëndësi domosdoshmërive të shekullit, rinisë dhe së ardhmes. Ishte armik i tmerrshëm i poetëve, letrarëve dhe shkrimtarëve që i çonin popujt dhe kombet në rrugë të shtrembra.²⁶⁵ Ai shtron pyetjen “Pse injoranti s’e mësoi dot edukatën e jetës?” Djali të paktën të bëhej njeri, të mos mbetej injorant!²⁶⁶ Ai është për një shoqëri të dijes, të shkencës, ngjashëm si Comte është për fitore ndaj mosdijes dhe hamendjes. Ai injorantin e quan të devijuar:

*Mirëpo injoranti kurrë s’mund të krahasohet me të diturin:
Injoranti është i verbër, ai s’e gjen dot rrugën e drejtë!²⁶⁷*

3. Raporti mes sistemit të vlerave dhe çështjeve sociale: Feja, moderniteti, nacionalizmi dhe morali

Feja është pjesë e qenies njerëzore, e cila është “pashërueshëm fetare” (Shushnjq), dhe “gjallesë metafizike” (Schopenhauer). Akifi mund të thuhet se është një poet religjiocentrist, në korpusin e tij shprehur me fjalët e Bellahut “simbolet fetare shihen si shprehje e realitetit të pareduktueshëm, shprehje e realitetit të veçantë”, kurse feja si “tërësi e formave dhe akteve simbolike që e lidhin njeriun me kushtet bazë të ekzistencës së tij”.²⁶⁸ Feja është një ndër konceptet bazë me të cilin merret dhe ndaj të cilit ka konsideratat më të larta Pejani. Feja, ngjashëm si te Durkheimi, është burim i të gjitha institucioneve sociale. Akifi është kundër

²⁶⁴ *Fletët*, f. 313.

²⁶⁵ *Fletët*, *Parathënia*.

²⁶⁶ *Fletët*, 139.

²⁶⁷ *Fletët*, 245.

²⁶⁸ Pajaziti, *po aty*, f. 70-71.

ateizmit, të cilin e quan fe të re, pra e sheh si një pseudofe (Njerëzimi ateizmin një fe të re e njeht²⁶⁹), përhapja e së cilës shkakton probleme serioze si për jetën individuale, ashtu edhe për atë shoqërore. Ai kritikon veprën e Tevfik Fikretit, *Tarihi Kadim* (Histori e vjetër, 1905), “traktat ky blasfemie” që la mbresa të thella mbi intelektualët dhe të rinjtë e asaj kohe që e lexonin, që “e këputi besimin nga zemra e foshnjave!” Blasfeninë e quan errësirë. Ai thotë se “për të çarë me gjithçka në rrugën e përparimit, udhëzues duhet pasur “cilësinë e natyrës suaj shpirtërore”, se pa të shpresa për shpëtim është e kotë!²⁷⁰

Është feja që e mban shoqërinë në këmbë;

Veç fesë s'ka lidhje tjetër!

O popull që përqafoheni për bajram,

Njerëzit lidhur ç'fije i mban?

Ty të ka rënë në pjesë kjo fe;

Po iku feja, i shkatërruar je!²⁷¹

Fenë e ndërlihd me sistemin e vlerave, me sfondin moral-etik të shoqërisë dhe thotë se burimi kryesor i moralit është devocioni, përkushtimi dhe frika nga Krijuesi:

Moralin as kultura, as ndërgjegjja s'e lartëson,

Ndjenja e virtytit te njerëzit nga frikë e Zotit buron.

Fenë e sheh si çimento sociale pa të cilën shoqëria rrënohet, e sheh atë si përfaqësues kolektiv, si busull sociale, kurse keqpërdorimin e saj si rrugë drejt humnerës. Është kjo konsideratë për fenë që e bëri që përkthimin e Kuranit t'ia linte një dijetari ez'heras,²⁷² me kusht që ta digjte duke u frikësuar se qeveria shekullare republikane turke do t'ia impononte popullit në lutje-adhurimet ditore.²⁷³ Ja, pra, ndërgjegjja fetare dhe sociale e një kolosi si Akifi.

Akifi është një moralist i përbetuar, moralin-etikën e konsideron tharm të shoqëriindërtimit të mirëfilltë. Ankohet e

²⁶⁹ *Fletët*, f. 256.

²⁷⁰ *Fletët*, f. 288.

²⁷¹ *Fletët*, f. 682.

²⁷² Jozgatlli Ihsan Efendiut.

²⁷³ Erverdi (ed.), f. 78.

kërkon rrugëdalje nga devijimet sociale të kohës, si: alkoolizmi, kurvëria, bixhozi, pornografia, rrallimi i martesave...

Poezi e rini tjetër ç'janë veç birrë e kurvëri?

Endacakë: askush s'ka profesion, moral;

Të gjithë filozofë, por shumica s'kanë as shkollë!^{274]}

Turli gjëra ngjitëse: ethe, kurvërim, pije, kumar.^{275]}

Sipas tij, populli mund të shpëtojë vetëm nëse çmon dhe ngre vlerat morale dhe, nga ana tjetër, dobësimi i frymës kombëtare e dobëson edhe moralin: "Ekziston vetëm një mundësi për shpëtim të vërtetë: Të ngrihet morali!" Ai virtytet i quan cilësi të besimit, kurse mosbesimin parashenjë të disfatës, madje edhe të njerëzve më të ditur: "Ndërsa njerëzit e virtytshëm janë treguesi i besimit, / Shumë të ditur, nga mosbesimi disfatë pësojnë!"^{276]} Ai është për ngjizjen e treshes shkencë, moral dhe teknologji: "Duhet shkencë, teknologji dhe moral i lartë!"^{277]} Sipas ekspertit të veprës akifiane, M. Ertugrull Dyzdag, Pejani "bindjet i kishte ngritur mbi këtë formulë sociale: Fe = moral + atdhedashuri + ditori".^{278]}

Ersoji çmon shumë traditën dhe tradicionalizmin,^{279]} kundërshton mitin dhe mitologjinë si "botëvështrim i deformuar";^{280]} këtë të fundit e ndërlidh me besëtytnitë dhe me faraonin, me kulturën faraoniane. Ai qan pse intelektualët e kuptojnë fenë gabim dhe përpiqen ta eliminojnë, kurse populli, duke e lënë fenë e vërtetë, merret me besëtytni dhe supersticiozitet.^{281]}

Ai është kundër atomizimit shoqëror, kundër gjendjes së mungesës së lidhshmërisë dhe të përbashkësisë me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. Ai thotë se *bashkimi jep jetë e lartëson, përçarja*

²⁷⁴ *Fletët*, f. 285.

²⁷⁵ *Fletët*, f. 462.

²⁷⁶ *Fletët*, f. 625.

²⁷⁷ *Fletët*, f. 526.

²⁷⁸ *Fletët*, parathënia.

²⁷⁹ Erverdi (ed.) f. 73.

²⁸⁰ Shih: Milazim Krasniqi, *Letërsia dhe besimet fetare*, Logos-A, Shkup, 2010, f. 25.

²⁸¹ *Fletët*, Parathënia.

djeg e vdes (İttihad Yaşatır Yükseltir, Tefrika Yakar Öldürür).^{282]} I lutet Zotit që të shmangë përçarjet që rëndojnë mbi shpinën e bashkësisë gjithislame (*ummeti*).

Hiqe nga mesi pengesën e bashkimit të penguar;

O Zot, të mos shtypet më ummeti nga kjo përçarje

Që vazhdon me shekuj, të mos mbet' i pashpresuar!^{283]}

Kritikon mediat e kohës si mbjellës të farës së përçarjes:

Gazetat që dalin me turli titujsh, pa numërim,

Hedhin në vend farën e përçarjes pa ndalim.^{284]}

Në konceptin e tij për modernitetin përjashton idetë për përmbysjen e fesë dhe të moralit, përkundrazi insiston në përhapjen e tyre. Ai qahet pse shoqëria islame ka mbetur e huaj edhe për shkencën e djeshme, brengoset tepër për mungesën e shkencës dhe teknologjisë, si shkak i nëpërkëmbjes dhe rrëzimit të brezit. Ai thotë se

Forca e kuptimit të popullit të mjerë u shkatërrua,

Nuk merret kush me shkencë, i mbyllur vendi i teknologjisë;

Emri i industrisë është fundosur, po ashtu dhe i tregtisë;

Bujqësi, por me metoda të profetit Adem!^{285]}

Ai e ndjen këtë gjendje plot përvëlím shpirtëror dhe tregon edhe rrugëdaljen nga kjo agoni:

Vetëm në shkencën e Perëndimit ta ktheni fytyrën,

Së bashku me djemtë natë e ditë të bëni detyrën;

Diturinë e shkuar treqindojeçare ta fitoni me forca të bashkuara.

Burimet e panumërta të dala në truallin e teknologjisë,

Edhe pijini, edhe ujërat e tyre të dobishme sillini në atdhe.^{286]}

Në këtë kontekst, Ersoji merr shembull Rusinë dhe në veçanti Japoninë, e cila nuk është tëhuajësuar, ka marrë teknologjinë, por ka ruajtur unin e vet identitar (E keqja e ardhur si modë, kalbet në doganë!)

Akifi është kundër ndjenjës së nacionalizmit, të cilin e quan

²⁸² *Fletët*, Parathënia.

²⁸³ *Fletët*, f. 682.

²⁸⁴ *Fletët*, f. 278.

²⁸⁵ *Fletët*, f. 357.

²⁸⁶ *Fletët*, f. 528.

“prapësi”.²⁸⁷ Ai thotë: “S’ e kuptova, s’ mundem ta kuptoj se si ju hyri në tru ndjenja për t’u ndarë e copëtuar. A djalli jua shtiu në mendje idenë e kombësisë? Ideja e kombësisë është tërmeti që do ta shembë nga themelet Islamin që mban të bashkuar nën një kombësi kaq shumë kombësi të dalluar nga njëri-tjetri”.²⁸⁸ Paska në muslimanllëk përçarje? Pejgamberi e mallkon idenë e nacionalizmit²⁸⁹ dhe të fanatizmit etnik. Në një vend tjetër thotë: As marrëzi partish na duhet, as hall nacionalizmesh!²⁹⁰ Në këtë kontekst duhet përmendur se përkthyesi në kontekstin negativ ka përdorur fjalën *kombësi* që është term pozitiv, gjendje natyrore e grupeve shoqërore, që mendojmë se duhej përkthyer me *nacionalizëm*. Duhet theksuar se edhe Akifi, si gjithë njerëzit, ka përjetuar një evoluim ideor, kështu që është interesante se në poezitë e vitit 1912 idenë për kombin e paraqet gjendje të defektit shoqëror (Fromm),²⁹¹ kurse në Marshin e Pavarësisë²⁹² flet për yllin e kombit të tij, për yllin e tij, vetëm të kombit të tij...

Për ty, për kombin tim s’do të ketë më perëndim!

Flamuri im i lirë që e do lirinë, ka të drejtë të rrojë në liri!

Kombi im që i falet Zotit, ka të drejtë të rrojë në pavarësi!

Megjithatë duhet shënuar se në himnin kombëtar, Akifi kombëtarizmen prapë e ndërlihdh me fenë, me ezanet, me lutjen, me Zotin, me tempullin, me dëshmorin (shehidin), pra flet për një lloj të nacionalizmit fetar. Disa thonë se bën dallim mes racizmit (*kaumijet*) që zhbën indin shtetëror dhe kombit (*millijet*),²⁹³ të cilit i përshkruan tipare pozitive të shoqëriindërimit. Ai synon një sistem bashkësinor, në të cilin pjesëtarët e saj sillen dhe veprojnë sipas ndjenjave dhe mendimeve të përbashkëta □

²⁸⁷ Yusuf Hamzaoglu, *Balkan Türklüğü*, I, Logos-A, Shkup, 2010, f. 76.

²⁸⁸ *Fletët*, f. 279.

²⁸⁹ *Fletët*, f. 302.

²⁹⁰ *Fletët*, f. 367.

²⁹¹ Gjendje kur pjesa më e madhe e anëtarëve të një shoqërie nuk e kanë arritur qëllimin e lirisë, të spontanitetit, nuk e kanë njohur unin e vet dhe janë në gjendje të tjetërsimit kolektiv.

²⁹² Botuar në *Sebilurreshad*, vëll. 18, nr. 468, f. 305, 17 shkurt 1921, Ankara.

²⁹³ Okay & Düzdağ, po aty.

kolektive, sipas “ne”-ndjenjës (Tönnies). Përveç me hallin e kombit dhe ummetit, ai merret edhe me letargjinë e Lindjes, që ishte në një gjendje inferiore ndaj Perëndimit (*Perëndimi punëtor-Lindja dembele*, “Lindja është sot larg. Edhe nga morali, edhe nga teknologjia”!, “Vatra të shembura, shtete të rrëzuara që kanë mbaruar.”). Gjithnjë duke u bashkëndjerë me vuajtjet e tokës së të jatit, mallkon krimin e bërë ndaj muslimanëve të Ballkanit, kryerësit e tij dhe shkaktarët.^{294]}

Përfundim(e)

Fletët e Pejani, që konsiderohet “bilbili i Islamit” dhe simboli i mendimit islam të një periudhe, janë interpretues i së kaluarës dhe i së ardhmes dhe asnjëherë nuk do ta humbin vlerën, sepse janë shkruar me shpirt, janë poezi konstruktiviste e jokonformiste. Në këtë vepër, autori bën një sociologji dhe antropologji islame, bazuar në parimet universale të njerëzishmërisë, dijes dhe tolerancës, që synon të krijojë harmoni mes shoqërisë dhe mësimëve hyjnore. Ai është ideator i solidaritetit social organik, i ekuilibrit social të bazuar në një *modus vivendi* islamik,^{295]} është ummetist, anticezarist dhe antidespotist, është kundër depersonalizimit dhe desocializimit. Opusi poetik i Pejani është një kryevepër, të cilën duhet ta kenë pranë të gjithë ata që bëjnë inxhinieringun social, që nga politikanët e deri te pjesëtarët e botës akademike, mësimdhënësit universitarë, shkencëtarët e profileve të ndryshme, në veçanti letrarët, sociologët dhe antropologët, islamologët dhe teologët. Leximi i këtij opusi ndihmon si mësimin e historisë së një shoqërie më të gjerë, ashtu edhe mënyrën se si janë perceptuar rrjedhat shoqërore nga një kokë e ndritur shqiptaro-osmane që jep një hartë dhe një projekt social mbi të cilin duhet të ndërtohet shoqëria funksionale. Është mjerim për një popull që të mos e përvetësojë një mendimtar kaq të madh si ky, që në tekstet e ndryshme dhe faqet elektronike të letërsisë shqipe të paraqiten emra anonimësish e të mos ketë vend për një vigan si Pejani, për një poet dhe arkitekt social

²⁹⁴ Halûk Harun Duman, *Balkanlara Veda*, DUYAP Yayıncılık, Stamboll, 2005, f. 114, 136. *Fletët*, f. 527, 667.

²⁹⁵ Okay & Düzdağ, po aty.

të përmasave madhore. Sugjerojmë institucionet shkencore të merren më tepër me krijimtarinë akifiane, të punojnë në popullarizimin e ligjëratës së tij.

Literatura e shfrytëzuar

DUMAN, Halûk Harun, *Balkanlara Veda*, DUYAP Yayıncılık, Stamboll, 2005.

ERSOJ, Mehmed Akif, *Fletët (Safahat)*, Logos-A, Shkup, 2009.

ERSOY, Mehmed Akif, *Safahat*, përg. M. Ertugrul Duzdag, Çagri Yayinlari, Stamboll, 2006.

ERVERDİ, Ezel dhe të tjerë (ed.), *Türk Dili ve Edebiyatı Ansiklopedisi*, Dergâh Yayınları, Stamboll, 1979, vëll. III.

HAMZAOĞLU, Yusuf, *Balkan Türklüğü*, I, Logos-A, Shkup, 2010.

IHSANOGLU, Ekmeleddin, *Historija osmanske države i civilizacije - II*, IRCICA & Orijentalni Institut u Sarajevu, Sarajevo, 2008.

KILIÇ, Ahmet Faruk, *Mehmet Akif Ersoy'un Din ve Toplum Anlayışı*, Değişim Yayınları, İstanbul, 2008.

KRASNIQI, Milazim, *Letërsia dhe besimet fetare*, Logos-A, Shkup, 2010.

OKAY, M. Orhan & M. Ertuğrul Düzdağ, "Mehmet Akif Ersoy", *TDV İslam Ansiklopedisi*, vëll. XVIII, Ankara, 2003.

PAJAZITI, Ali, *Fjalor i sociologjisë*, Logos-A & UEJL, Shkup, 2009.

"Prof. Dr. Suleyman Hayri Bolay ile Mehmet Akif'in Dusunceleri Hakkında", <http://yayim.meb.gov.tr/dergiler/sayi73/soylesi.pdf>

SENGULER, Ismail Hakki, *MEHMET AKIF KULLIYATI*, Hikmet Nesriyat, Stamboll, 1990.

http://www.worldlingo.com/ma/dewiki/en/Mehmet_Akif_Ersoy, 02.03.2011